



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA

EMPOWER Sektor i Privat i USAID-it
Buletini Nr. 2, maj 2015

FUQIZIM ME KRIJIM TË VENDEVE TË PUNËS!

FAKTE SHKURT

Takime me akterë

Druri

Shoqata e Përpunuesve të Drurit të Kosovës dhe EMPOWER Sektor i Privat i USAID-it mblodhën mbi 25 kompani të përpunimit të drurit për të nisur punën në lidhje me planin e veprimit 2015-2016 rreth pjesëmarrjes në panairin dhe ekspozitat vendore dhe ndërkombëtare të kësaj industrie.

Turizmi

EMPOWER Sektor i Privat u takua me akterët kryesorë në sektorin e turizmit rreth zhvillimit të segmentit të Via Dinaricës në Kosovë, një produkt i cili mund të sjellë profil global në tregun e turizmit për Kosovën. Pjesëmarrësit e takimit do të vazhdojnë me takime për ta zhvilluar këtë koncept tutje.

PAJISJET E SHESHEVE TË LOJËRAVE *MADE IN KOSOVA* JOSHIN BLERËSIT RAJONALË

Që nga viti 2004, Kompania Daqa ka krijuar emër për pajisjet e drurit për sheshe të lojërave për mjedis të hapur dhe të mbyllur.

"Bëmë hulumtimin e tregut dhe pamë se të gjitha pajisjet për sheshe të lojërave në Kosovë importoheshin. Ndaj vendosëm që të ndryshojmë linjën e prodhimit nga dyer, dritare dhe orendi në ekskluzivisht pajisje për sheshe të lojërave", thotë Nexhmedin Sadiku, pronar i kompanisë Daqa.

Ndryshimi ishte i lehtë, pasi kompania orientoi rreth 70% të pajisjeve për produktin e ri. Për shkak të kërkesës për pajisje për sheshe të lojërave, Daqa rriti numrin e punëtorëve nga 4 në 13. Pajisjet për sheshe të lojërave që prodhohen nga Daqa projektohen dhe prodhohen sipas normave evropiane të sigurisë. Kompania ofron edhe shërbime të montimit dhe inspektimit për të garantuar sigurinë maksimale për fëmijët.

Në mars të këtij viti, Daqa ishte një nga pesë kompanitë e përpunimit të drurit që mori pjesë në Panairin Ndërkombëtar të Mobiljeve SHQIPËRIA 2015. Ky udhëtim doli të jetë i suksesshëm për Daqa: kompania i shiti të gjitha produktet e sjella për ekspozitë dhe nënshkroi kontrata për të realizuar 4 projekte të shesheve të lojërave për mjedis të jashtëm në Shqipëri.

"...bashkëndarja e kostos nga EMPOWER Sektor i Privat i USAID-it na lehtësoi ... Jam i ngazëllyer me suksesin që kishin këtë vit". – Nexhmedin Sadiku, pronari i kompanisë DAQA



Sheshi i lojërave DAQA në Nën Panairin Ndërkombëtar të Mobiljeve SHQIPËRIA 2015

"Ngurroja të merrja pjesë në panair këtë vit, që do të ishte hera e pestë", thotë Sadiku, "por përkrahja me bashkëndarjen të kostos nga EMPOWER Sektor i Privat i USAID-it ma lehtësoi punën e shpenzimeve dhe të logjistikës. Jam i ngazëllyer nga suksesi që patëm në panair këtë vit".

Për Sadikun, i cili është inxhinier i përpunimit të drurit, tani është koha për t'i zgjeruar aktivitetet. Përvoja në panairin në Shqipëri këtë vit ka jetësuar plane më të mëdha dhe ai po llogarit në përkrahjen nga USAID-i për të arritur këtë aspiratë.



Zëvendësudrejtori i EMPOWER Sektorit Privat i USAID-it, Skënder Rama, mysafir i programit të mëngjesit në Klan Kosova

PËRHAPJA E FJALËS

Ne dolëm në TV për të folur rreth fushëveprimit të EMPOWER Sektorit Privat, skemën tonë të grantit dhe procesin e aplikimit: në televizionin kombëtar TV Klan 'Mysafiri i mëngjesit' dhe në televizionin rajonal TV Tema - Ferizaj 'VIP Intervista'.

GRATË NË FOKUS

EMPOWER Sektorit Privat ka të bëjë me krijimin e vendeve të punës. Besojmë se me rritjen e pjesëmarrjes së grave në të gjitha aspektet e ekonomisë, krijojmë jo vetëm vende pune për gratë, por për të gjithë. Lëvizja për gratë në biznes po rritet vërtetë.

Teknologjia nuk ka gjini

EMPOWER Sektorit Privat po mbështet programin e trajnimit 'Femrat në IT', që realizohet nga Instituti i AUK-ut për Trajnim dhe Zhvillim. Me përkrahjen tonë, njëzet gra po vijnë në programin dhe po kualifikohen në tri profile të TIK, gjë që shton gjasat e tyre për punësim. Në konferencën e organizuar nga AUK-u më 23 prill 2015 për shënimin e Ditës Ndërkombëtare të Vajzave në TIK, David T. King nga EMPOWER Sektorit Privat përgëzoi të rejtat e Kosovës të cilat filluan trajnimin një-vjeçar, duke shtuar se "Me krijimin e vendeve të punës për gratë, ne i ndihmojmë kompanive të forcohen dhe të punësojnë më shumë gra e burra. Diversiteti gjinor është vlerë themelore e punës, sepse gratë me talentin e tyre i bëjnë kompanitë më të suksesshme dhe më konkurruese". TIK është sektor i shkëlqyeshëm për punësim dhe zhvillim personal të grave dhe vajzave.



Drejtori i EMPOWER Sektorit Privat i USAID-it, David T. King, në Konferencën në AUK me temë: 'Femrat në IT'



Të rejtat nga programi i trajnimit 'Femrat në IT'

Investimi tek gratë ka normë të lartë të kthimit

Për shumë gra që janë pronare të biznesit, sfidat kryesore janë shtrirja në tregjet e reja dhe qasja në fonde për zgjerim të aktiviteteve. EMPOWER Sektorit Privat takoi mbi 30 organizata të grave të cilat janë të përfshira aktivisht në fuqizimin ekonomik dhe shoqëror të grave tjera dhe të rinjve, si dhe me gratë pronare të bizneseve nga pjesë të ndryshme të Kosovës, për të mësuar nga to se cilat janë barrierat me të cilat ballafaqohen gjatë punës dhe cilat janë burimet dhe aftësitë e nevojshme për të arritur sukses. Fuqizimi i bizneseve që janë pronë e grave ose menaxhohen nga gratë dhe krijimi i më shumë mundësive për punësim për gratë është një nga objektivat kryesore të ndërthurura të EMPOWER Sektorit Privat.



Ndërmarrëset gra ndajnë storjet dhe sfidat e tyre

Na kontaktoni

EMPOWER Sektorit Privat i USAID-it

Rruga Pashko Vasa nr.6

Qyteza Pejton, Prishtinë

+381 38 222 855

info@empowerkosovo.org

www.empowerkosovo.org

<https://www.facebook.com/empowerkosovo>

EMPOWER Sektorit Privat i USAID-it, i cili nisi punën në korrik 2014, është projekt pesë-vjeçar i dizajnuar për të nxitur krijimin e vendeve të punës në shkallë të gjerë duke ngritur rritur konkurrueshmërinë e kompanive kosovare. Projekti financohet nga USAID-i dhe implementohet nga Cardno Emerging Markets USA, Ltd.